



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3346/8 prot.

Datë 11.12.2024

V E N D I M
Nr. 1758/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NET-GROUP & DAAM” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-23878-10-10-2024, me objekt: “*Projekte teknike*”, me fond limit 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjet e tre mijë e treqind e tridhjet e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Ankimues: BOE “NET-GROUP & “DAAM” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “NET-GROUP” SHPK me Nipt L72023002P dhe adresë: Rr. "Vorpset", pas restorant "Piazza", ZK 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fushë-Arrëz.
Adresa: Qendër Fushë-Arrëz.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. **REF-23878-10-10-2024**, me objekt: “Projekte teknike”, me fond limit 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjet e tre mijë e treqind e tridhjet e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

II.2. Në datën 24.10.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 06.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. LENI-ING SHPK	3,306,140.00 lekë	Kualifikuar
2. BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK	2,929,164.00 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 07.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Operatori ekonomik BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyen si më poshtë:

“Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika B, keni deklaruar ofertën si operatorë të pavarur, ndërkohë në akt marrëveshjen e ngarkuar në sistem rezulton B.O.E, kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, germa (a) Shtojca 10.

-Tek licenca për projekte e paraqitur nga O.E “DAAM”, mungon kategoria 9/a, kërkuar në DST sipas pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1.”

II.5. Në datën 13.11.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/4785 dhe me nr. 3346/2024 prot, datë 13.11.2024 e operatorit ekonomik BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar, duke pretenduar: “[...] ju bëjmë me dije se operoret ekonomike NET-GROUP SHPK dhe DAAM SHPK, kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të konkurruar së bashku si bashkim operatorësh, e justifikuar kjo me: Kontratën e Bashkëpunimit dhe Prokurën e Posaçme sipas pikës 1 në DST “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT ku citohet se “Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Plotësimin e duhur të pikës A, Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik në FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT, ku secili nga operatorët ekonomikë pjesë e BOE ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku ka cituar qartësisht pjesëmarrësit në BOE dhe rolin e secilit (Përfaqësues i BOE/Anëtar i BOE).

Përzgjedhjen e të dy operatorëve ekonomikë në seksionin Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë gjatë aplikimit në SPE, sikurse udhëzohet edhe nga manuali i përdorimit të SPE. Përsa i përket argumentit tuaj se nuk plotëson kriteret e DST-së, si më poshtë: Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika B, keni deklaruar ofertën si operatorë të pavarur, ndërkohë në akt marrëveshjen e ngarkuar në sistem rezulton B.O.E, kërkuar në DST sipas pikës 2, ju bëjmë me dije se bazuar në LIGJIN nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” si dhe LIGJIN nr. 16/2024 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 162/2020 “PËR

PROKURIMIN PUBLIK”, bazuar ne VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK (ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021, ndryshuar me Vendimin Nr. 498 datë 1.8.2024, ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024) dhe sidomos bazuar në VENDIMIN NR.08, DATË 23.09.2024 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT PËR MALLRA, PUNE, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT E HAPUR E THJESHTUAR (në të cilën bazohet edhe kjo procedurë prokurimi), seksioni i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në pjesën II. Shkaqet e përjashtimit, pika B deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura, me ndryshimin e formatit sipas VENDIM NR.08, DATË 23.09.2024, ka ndryshuar si më poshtë duke e hequr alternativat ku operatorët ekonomike zgjedhin në pikën 6 nëse konkurrojnë të vetëm, janë pjesë e bashkimit të operatorëve apo janë në marrëdhënie nënkontraktimi. Në vend të saj, duke parashikuar të dy rastët dhe duke hequr nga operatorët ekonomike detyrimin për të përzgjedhur si alternativa nëse konkurrojnë të vetëm apo si bashkim operatorësh, citohet si më poshtë:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë

Bashkëlidhur paraqitet edhe me ilustrim pika B Deklarata “Për dorëzimin e Ofertave të Pavarura” sipas modelit të vjetër të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe sipas modelit të ri të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku e theksojmë se vetë formati nuk lejon që operatorët të përzgjedhin nëse konkurrojnë të vetëm apo si bashkim operatorësh pasi nuk janë paraqitur si alternativa, duke lënë si deklaram të konkurimit të vetëm apo si bashkim operatorësh, vetëm pjesën I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik në FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT, ku operatorët ekonomikë duhet të citojnë qartësisht nëse konkurrojnë te vetëm apo si BOE, ku në rastin e dytë kanë dhe detyrimin që të citojnë pjesëmarrësit në BOE dhe rolin e secilit.

Si përfundim, nisur nga arsyeja e skualifikimit të ofertës, pretendimi i BOE NET-GROUP SHPK & DAAM SHPK është se Autoriteti Kontraktor ka gabuar në vlerësimin e ofertës, sepse nuk është bazuar në modelin aktual të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit i miratuar sipas VENDIMIT NR.08, DATË 23.09.2024 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT PËR MALLRA, PUNE, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT E HAPUR E THJESHTUAR” .

Për këtë arsye, kërkojmë rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga BOE “NET-GROUP” SHPK & “DAAM” SHPK dhe pranimin përfundimtar të saj, duke shfuqizuar vendimin fillestar për skualifikimin e kësaj oferte.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.3346/2 prot., datë 14.11.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokoli 3346/2024 datë 13.11.2024.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4386 prot., protokolluar me tonën me nr. 3346/3 prot., datë 20.11.2024 ka përcjellë Vendimin nr.29, datë 20.11.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me ankesën e BOE “NET-GROUP SHPK & DAAM” SHPK, ku konstatohet se KSHA ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr 4394 prot., datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3346/4 prot., datë 25.11.2024.

II.9. Nga shqyrtimi i ankesës rezulton, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-se mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “NET-GROUP SHPK & DAAM” SHPK, i cili në formularin e ankesës ka paraqitur pretendime vetëm për një arsye skualifikimi. Ndërkohë, KPP nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatoi, se autoriteti kontraktor ka paraqitur dy arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues.

II.10. Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 3346/5 prot., dat 06.12.2024, KPP iu drejtua operatorit ekonomik ankimues, duke kërkuar paraqitjen e tij pranë zyrave të KPP-së me datë 11.12.2023 ora 09:30, shoqëruar nga një person i cili disponon të dhënat për tu futur në llogarinë e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.11. Rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin e bërë me shkresën nr. 3346/5 prot., dat 06.12.2024.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “NET-GROUP SHPK & DAAM” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 13.11.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/4785 dhe me nr. 3346/2024 prot, datë 13.11.2024 e operatorit ekonomik BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar, duke pretenduar: “[...] ju bëjmë me dije se operatorët ekonomikë “NET-GROUP” SHPK dhe “DAAM” SHPK, kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të konkurruar së bashku si bashkim operatorësh, e justifikuar kjo me: Kontratën e Bashkëpunimit dhe Prokurën e Posaçme sipas pikës 1 në DST “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” ku citohet se “Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Plotësimin e duhur të pikës A, Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik në **FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT**, ku secili nga operatorët ekonomike pjesë e BOE ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku ka cituar qartësisht pjesëmarrësit në BOE dhe rolin e secilit (Përfaqësues i BOE/Anëtar i BOE).

Përzgjedhjen e të dy operatorëve ekonomike në seksionin Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë gjatë aplikimit në SPE, sikurse udhëzohet edhe nga manuali i përdorimit të SPE. Përsa i përket argumentit tuaj se nuk plotëson kriteret e DST-së, si më poshtë: Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika B, keni deklaruar ofertën si operatorë të pavarur, ndërkohë në akt marrëveshjen e ngarkuar në sistem rezulton B.O.E, kërkuar në DST sipas pikës 2, ju bëjmë me dije se bazuar në **LIGJIN nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”** si dhe **LIGJIN Nr. 16/2024 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK”**, bazuar në **VENDIMIN Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”** (ndryshuar me **Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021, ndryshuar me Vendimin Nr. 498 datë 01.08.2024, ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024**) dhe sidomos bazuar në **VENDIM NR.08, DATË 23.09.2024 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT PËR MALLRA, PUNE, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT E HAPUR E THJESHTUAR** (në të cilën bazohet edhe kjo procedurë prokurimi), seksioni i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II Shkaqet e Përjashtimit, pika B Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, me ndryshimin e formatit sipas **VENDIM NR.08, DATË 23.09.2024**, ka ndryshuar si më poshtë duke e hequr alternativat ku operatorët ekonomikë zgjedhin në pikën 6 nëse konkurrojnë të vetëm, janë pjesë e bashkimit të operatorëve apo janë në marrëdhënie nënkontraktimi. Në vend të saj, duke parashikuar të dy rastet dhe duke hequr nga operatorët ekonomike detyrimin për të përzgjedhur si alternativa nëse konkurrojnë të vetëm apo si bashkim operatorësh, citohet si më poshtë:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë

Bashkëlidhur paraqitet edhe me ilustrim pika B Deklarata “Për dorëzimin e Ofertave të Pavarura” sipas modelit të vjetër të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe sipas modelit të ri të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku e theksojmë se vetë formati nuk lejon që operatorët të përzgjedhin nëse konkurrojnë të vetëm apo si bashkim operatorësh pasi nuk janë paraqitur si alternativa, duke lënë si deklaram të konkurrimit të vetëm apo si bashkim operatorësh vetëm pjesën I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik në FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT, ku operatorët ekonomikë duhet të citojnë qartësisht nëse konkurrojnë të vetëm apo si BOE, ku në rastin e dytë kanë dhe detyrimin që të citojnë pjesëmarrësit në BOE dhe rolin e secilit.

Si përfundim, nisur nga arsyeja e skualifikimit të ofertës, pretendimi i BOE “NET-GROUP” SHPK & “DAAM” SHPK është se Autoriteti Kontraktor ka gabuar në vlerësimin e ofertës, sepse nuk është bazuar në modelin aktual të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit i miratuar sipas VENDIM NR.08, DATË 23.09.2024 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT PËR MALLRA, PUNE, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT E HAPUR E THJESHTUAR .

Për këtë arsye, kërkojmë rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga BOE “NET-GROUP” SHPK & “DAAM” SHPK dhe pranimin përfundimtar të saj, duke shfuqizuar vendimin fillestar për skualifikimin e kësaj oferte”.

III.1.2. Operatori ekonomik BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyen si më poshtë:

“Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika B, keni deklaruar ofertën si operatorë të pavarur, ndërkohë në akt marrëveshjen e ngarkuar në sistem rezultoni B.O.E, kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, gërma (a) Shtojca 10.

-Tek licenca për projekttime e paraqitur nga O.E “DAAM”, mungon kategoria 9/a, kërkuar në DST sipas pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1.”

III.1.3. Nga shyrtimi i ankesës rezulton, objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “NET-GROUP & DAAM” SHPK, i cili në formularin e ankesës ka paraqitur pretendime vetëm për një arsye skualifikimi. Ndërkohë, KPP nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatoi, se autoriteti kontraktor ka paraqitur dy arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues.

III.1.4. Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 3346/5 prot., dat 06.12.2024, KPP iu drejtua operatorit ekonomik ankimues, duke kërkuar paraqitjen e tij pranë zyrave të KPP-së me datë 11.12.2023 ora 09:30, shoqëruar nga një person i cili disponon të dhënat për tu futur në llogarinë e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin e bërë me shkresën nr. 3346/5 prot., dat 06.12.2024.

III.1.5. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”.

III.1.6. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.7. Në nenin 110, pikat 3, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni. Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”

III.1.8. Në rastin konkret referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ si dhe raportit të auditit në sistemin e prokurimit publik rezulton, se autoriteti kontraktor ka paraqitur dy arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues BOE “NET-GROUP & DAAM”, SHPK, ndërsa në përmbajtjen e ankesës lidhur me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ky i fundit ka paraqitur pretendimet

vetëm për një arsye skualifikimi konkretisht për arsyen e skualifikimit “Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika B, keni deklaruar ofertën si operatore të pavarur, ndërkohë në akt marrëveshjen e ngarkuar në sistem rezultoni B.O.E, kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, gërma (a) Shtojca 10”, duke mos shfaqur asnjë pretendim në formularin e ankesës në lidhje me arsyen tjetër të skualifikimit nga autoriteti kontraktor, përse i përket plotësimit të pikës 2.3.1 konkretisht: “Tek licenca për projektme e paraqitur nga O.E “DAAM”, mungon kategoria 9/a, kërkuar në DST sipas pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1.”.”.

Në nenin 110, pikat 3, “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni. Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

Në rastin konkret KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues nuk i ka ezauruar të gjitha shkallët e ankimit në lidhje me pretendimet e tij mbi arsyet e skualifikimit nga autoriteti kontraktor, pasi për njërin prej arsyeve të skualifikimit (e cila rezulton e provuar nga materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ), nuk ka shfaqur pretendime në formularin e ankesës, duke sjellë në këtë mënyrë edhe rënien në dekadencë të së drejtës së tij dhe humbjen e afatit të ankimit në lidhje me këtë pretendim në kuptim të nenit 110, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër KPP gjykon, se edhe pretendimi i operatorit ekonomik ankimues mbi arsyen e skualifikimit të autoritetit kontraktor të cilën e ka shprehur në formularin e ankesës, nuk do të merret në shqyrtim, pasi edhe nëse hipotetikusht ky pretendim do të qëndronte, operatori ekonomik ankimues do të vazhdojë të mbetet i skualifikuar, për arsye se ai nuk ka ezauruar shkallët e ankimit për arsyen tjetër të skualifikimit të paraqitur nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik animues.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik BOE “NET-GROUP SHPK & DAAM” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-23878-10-10-2024, me objekt: “*Projekte teknike*”, me fond limit 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik BOE “NET-GROUP SHPK & DAAM” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri